



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit H.A. nga fshati K. i M. , Komuna e M., për shkak të veprës penale Vrasja në tentativë nga neni 178, lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PKR.nr.40/19, të datës 06.09.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.593/2023, të datës 20.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 29.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit H. A., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PKR.nr.40/19, të datës 06.09.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.593/2023, të datës 20.03.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.40/19, të datës 06.09.2023, i dënuari H. A., është shpall fajtor për shkak të veprës penale Vrasja në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK dhe i është shqiptuar, për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të aktgjykimit , me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3(tri) viteve dhe

Për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Në pajtim me nenin 80 të KPRK , të dënuarit ,gjykata i ka shqiptuar dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 3(tre) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 26.10.2018 e deri më datë 20.12.2018 dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 20.12.2018 e deri më datë 20.01.2019 i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim.

Është obliguar i dënuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50 €.

I dëmtuari Sh. D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.593/2023, të datës 20.03.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, mbrojtësit të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit H. A., avokati Vehbi Beqiri, për shkak të shkeljes së ligjit penal, dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo në rastin më ta pavolitshëm aktgjykimet të ndryshohen dhe të dënuarit dënimi ti zëvendësohet me një dënim alternativ.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.163/2024, e datës 21.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit H. A., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1, lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se, aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3.8, 1.12 dhe paragrafi 2 të KPP-së, sepse në aktgjykim nuk janë arsyetuar faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të kodit penal, si dhe gjykata me rastin e shpalljes fajtorë të dënuarit, nuk ka paraqitur arsyet e aktgjykimit dënues dhe as rrethanat në të cilat bazohet dënimi fajësues, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij

dhe aktgjykimi nuk përmban arsyet për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë ,janë në kundërshtim të plotë me provat dhe shkresat e lëndës,. Më tutje në kërkesën e mbrojtjes theksohet se dispozitivi i aktgjykimit është kopje e dispozitivit të aktakuzës dhe nuk pasqyron rrjedhën e gjykimit dhe provave të proceduara, ashtu siç e përcakton dispozita e nenit 361 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të KPP-së.

Më tej në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit pretendohet se është bërë edhe shkelja e ligjit penal në dëm të dënuarit, si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale në dëm të dënuarit, sepse i dëmtuari kishte dhënë deklarata në tërësi kontradiktore në procedurën paraprake dhe në shqyrtim gjyqësor dhe asnjë deklaratë tjetër nuk kishte të bënte me ngjarjen ditën kritike. Theksohet se kanë munguar elementet qenësore të kauzalitetit të veprimit të dënuarit dhe të viktimës dhe se nuk është përmbushur asnjë element i veprës penale vrasje në tentativë.

Gjithashtu mbrojtësi i të dënuarit i ka kundërshtuar edhe vendimet e gjykatës edhe sa i përket vendimit mbi dënimit.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit.

Duke ju referuar pretendimeve të mbrojtjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se dispozitivi i këtyre aktgjykimeve është i qartë, nuk është në kundërshtim me vetveten dhe është në harmoni me arsyetimin e tyre.

Gjithashtu, duke ju referuar pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është përshkruar në mënyrë të hollësishme vepra penale për të cilën është shpall fajtor i dënuari H. A., së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal.

Nga kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se janë paraqitur këto elemente të figurës së veprës penale dhe atë: koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale dhe mënyra e kryerjes së veprës penale nga i dënuari, janë përshkruar të gjitha veprimet inkriminuese të të dënuarit të ndërmarra ndaj tani të dëmtuarit Sh. D..

Në këtë mënyrë, rezulton se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, tek pjesa e përshkrimit të veprimeve kryerëse janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të gjitha rrethanat dhe faktet të cilat i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale për të cilën është shpall fajtor i dënuari H. A.

Po ashtu, edhe në arsyetimin e këtij aktgjykimi shihet qartë që janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit, përshkrimet e dhëna në arsyetim

përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënëse, ndërsa pjesa e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë përfshirë arsyet në lidhje me vlerësimin e pretendimeve ankimore, si dhe shkeljet, për të cilat gjykata në fjalë është kujdesur sipas detyrës zyrtare.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe nga shkresat tjera të lëndës rezulton se në këtë rast janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar në nenin 361, paragrafi 2 të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, ku pastaj pas një procesi të tillë, mandej janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe aspekte tjera juridike.

Përveç që nuk janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, me aktgjykimet e lartcekura nuk është shkelur as ligji penal në dëm të dënuarit H.A., pasi që veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178, lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilat i dënuari është shpall fajtor.

Në këtë mënyrë duke ju referuar edhe të dhënave tjera të cilat mund të vërtetohen nga shkresat e lëndës, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të gjitha provave ka vërtetuar faktin se ditën kritike paraprakisht kishte pasur një konflikt në mes të dënuarit dhe të dëmtuarit kjo u vërtetuara nga deklaratat e palëve të dëmtuarit dhe të dënuarit, faktin se ky konflikt kishte filluar pasi që i dënuari H., i ishte vënë në ndjekje të dëmtuarit pasi që kishte dyshuar se është personi i cili më herët i kishte vjedhur shtëpinë dhe në këtë kuptim i kishte shkuar pas tij deri në momentin kur i kishte dalë nga mbrapa shkurreve të njëjtit dhe kishte filluar dhe kacafytja ballë për ballë, e trup për trupi duke pasuar pastaj edhe me goditjen me armë. Faktin se pas konfliktit i dëmtuari kishte shkuar në shtëpi ashtu i plagosur e vërtetuan edhe dëshmitarët të cilët u dëgjuan në shqyrtimin gjyqësor. Faktin se pas konfliktit të ndodhur –plagosjes së të dëmtuarit në shtëpinë ku jeton i njëjti me prind, nga familja e të dënuarit sipas ë drejtës zakonore i ishin dërguar njerëz me qëllim që të pajtohen për shkak të rastit të ndodhur me datë 25.10.2018, faktin se të dëmtuarit i ishin shkaktuar lëndime të rënda trupore nga arma e zjarrit në regjionin e parakrahut të dorës së majtë dhe në regjionin e kofshës së këmbës së majtë nga veprimi dinamik i predhave të hedhura nga arma e zjarrit, u vërtetua edhe përmes ekspertizës mjeko ligjore.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate i drejtë është konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se qëllimi dhe dashja e të dënuarit ka qenë e orientuar në atë drejtim që ta privoj nga jeta të dëmtuarin Sh. D.. Kjo për faktin se i dënuari fillimisht me shufër hekuri e ka goditur të dëmtuarin derisa e kishte rrëzuar për tokë, e më pas me armë zjarri nga afërsia ka shtënë tre herë në drejtim të të dëmtuarit, ku me dy nga ato të shtëna edhe e kishte goditur, njëherë në dorën e majtë dhe njëherë në këmbën e majtë për çka edhe i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore. Se i dënuari ka pasur qëllim që të dëmtuarin ta privoj nga jeta vërtetohet me vet faktin se nga afërsia ka shtënë ndaj të njëjtit tri herë edhe pse i njëjti fillimisht ishte rrëzuar nga vet ai pasi që e ka goditur me shufër hekuri, pra në

veprimet e të dënuarit vërehet qartë këmbëngulësia e tij për të privuar nga jeta të dëmtuarin. Se qëllimi i të dënuarit ka qenë privimi nga jeta i të dëmtuarit provohet edhe me faktin se i dënuari ka shtënë tri herë me armë zjarri në drejtim të dëmtuarit, që nënkupton se veprimet i ka pasur të vazhdueshme dhe nuk është ndalur as pas goditjes me shufër e as pas të shtënës së parë me armë, për të cilin pretendim të mbrojtjes gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm e me të cilin konstatim të gjykatës së shkallës së parë pajtohet edhe kjo gjykatë.

Përndryshe, duhet theksuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përmban edhe pretendime të caktuara që ndërlidhen me gjendjen faktike, mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, andaj edhe rrjedhimisht pretendimet e tilla të mbrojtësit të dënuarit nuk janë shqyrtuar fare.

Siç është theksuar edhe më parë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të vendimit lidhur me dënimin e shqiptuar, përkatësisht faktin se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, të dënuarit i është shqiptuar dënim i lartë. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar në suaza të dispozitës së lartcekur për veprën penale për të cilën i dënuari është shpall fajtor.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë theksuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Përndryshe, duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkualuar kompetencat ligjore, kështu që pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkualuar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërlidhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Andaj, nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.291/2024, më datë 29.05.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Afrim Shala